

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

**29.06.2021
Ora 12:37**

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Mospranimi për shqyrtim i Kërkesës Ankimore nr.56,
subjekti ankues Koalicioni ABEOK, me objekt “Pavlefshmëri të vendimeve
nr.406 deri 417, datë 23.06.2021 të KSHZ”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA (nuk është prezent),
Z.Ilirjan RUSMALI, Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Koalicioni:** ABEOK

Z. K. Bele: Çelim seancën publike të shqyrtimit të Kërkesës Ankimore nr.56 të subjektit ankues Koalicioni ABEOK me objekt “Pavlefshmëri të vendimeve nr.406 deri 417, datë 23.06.2021 të marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sepse mosmarrja e vendimit për miratimin e shtetit cënon përlllogaritjen dhe shpërndarjen e mandateve. Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë Koli Bele, sipas shortit të hedhur në datë 28 Qershor bazuar në nenin 29 të Kodit Zgjedhor. Kjo mbledhje e KAS-it për efektet e afateve po zhvillohet në ditën e sotme, dy anëtarët e tjerë të KAS-it ndodhen jashtë Tiranës dhe në pamundësi për të qenë prezent, mbledhja është korrekte dhe është kuorumi sipas rregullores prej 3 anëtarësh. Ndërkohë një nga anëtarët zoti Ledio Braho e presim mund të lidhet online gjatë mbledhjes dhe do të jetë i informuar për procedimin e kësaj seance. Të pranishëm janë Administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm si dhe

1

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

përfaqësuesi nga Koalicioni ABEOK kemi zotin Jenishehri. Zoti Jenishehri kisha një pyetje lidhur me tagerin e përfaqësimit pasi ky ankim është firmosur nga zoti Gjuzi, nuk e di a keni tagër ta përfaqësoni koalicionin?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Koalicioni ynë ka 4 drejtues të cilët kanë të drejta të barabarta edhe unë jam një prej atyre, dhe Kryetar i Partisë Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë.

Z. K. Bele: Po jemi të qartë se kemi pasur dhe seanca të mëparshme dhe palët për KAS është e njohur prezenca dhe nga çështjet e mëparshme në kuadër të këtyre zgjedhjeve. Besoj duke qenë se edhe ju keni qenë prezent në disa raste të seancave përgatitore, risjellim në vëmendje që seanca e sotme nuk ka të bëjë me shqyrtimin e themelit të çështjes, por vetëm me përmbushjen e kritereve formale të ankimit të cilat si forma e ankimit, kompetenca e KAS-it për shqyrtimin e ankimit dhe afati ligjor. Fillimisht i kërkojmë sekretarit të përgjithshëm të shprehet lidhur me këto elemente të formës konform neneve 124, 126 dhe vijues të Kodit Zgjedhor.

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar Kërkesa Ankimore nr.56, në datën 28.06.2021, ora 15:05 nga ankuesi Koalicioni ABEOK e cila kundërshton vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nga nr.406 deri 417, datë 23.06.2021 dhe kërkon pavlefshmërinë e vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i elementeve të formës dhe përmbajtjes që ka bërë administrata, rezulton se nuk janë në përputhje me nenin 126 të Kodit Zgjedhor pasi mungon përshkrimi i shkurtër i shkeljes të pretenduar, mungon përshkrimi i fakteve argumenteve dhe dispozitave ligjore tek të cilat mbështetet ankimi si dhe tregimin e provave për të cilat tregon gjatë procesit të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*


shqyrtimit administrativ. Gjithashtu nuk plotësonte dhe elementin një nga elementet 130 të Kodit Zgjedhor dhe konkretisht germën “c”, të nenit 130 i cili në respektim të afateve ligjore për ankimin. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është marrë në datën 23 Qershor 2021, sipas nenit 9 të rregullores së KAS-it kundër vendimit të Komisionerit mund të bëhet brenda 3 ditësh ankim nga marrja e vendimit. Duke bërë llogaritjet data 23, 24, 25 llogaritja e afateve i bie që në datën 25 duhet të ishte paraqitur ankimi. Në këto kushte nuk plotëson dhe kriterin e respektimit të afatit ligjor. Kështu që administrata propozon mospranimin për shqyrtim të ankimit të paraqitur nga ABEOK.

Z. K. Bele: Faleminderit zoti Merkaj, përfaqësuesi zoti Jenishehri lidhur me elementet e formës për aq sa ju intereson me atë çfarë parashtroi sekretari i përgjithshëm.

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Kisha një kërkesë paraprake, ne kemi ardhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendimet për të cilët ankohe mi dhe zyra e protokollit nuk na e ka dhënë me pretendimin se akoma nuk është zbardhur vendimi i datës 23 për të cilën bën fjalë i ankuari. Kemi ardhur vazhdimisht, kemi ardhur dhe dje dhe nuk na e kanë dhënë, na kanë dhënë numrat e vendimeve dhe na kanë thënë që meqënëse nuk janë zbardhur vendimet akoma, atëherë ju ankimin mund ta bëni duke shkruar vetëm numrat dhe na kanë thënë numri është nga 406 deri në 417. Sot është dita e fundit 5 ditë afat edhe ne e kemi paraqitur kërkesën megjithëse nuk i kemi pasur vendimet në dispozicion. Ne kërkojmë që të na jepni në dispozicion vendimet e zbardhura në qoftë se janë bërë sot se dje nuk ishin bërë siç e kemi thënë dhe këtu në kërkesën tonë që nuk jemi disponibël të vendimit duke qenë se Komisioni Qendror të Zgjedhjeve nuk i ka

3

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

zbardhur akoma që dje kur kemi dorëzuar që mbaronte dhe afati 5 ditorsh që të ankoheshim. Prandaj në këtë pozicion ne e quajmë sikur pretendimi i KQZ-së zotit parafolës nuk qëndron dhe me thënë të drejtën ne kemi një opinion për Administratën e KQZ-së, e cila nuk është në lartësinë e duhur. Njerëzit e KQZ-së si dhe nëpër rruga na duhet të presim minuta të tëra për të ardhur në punë ai për të na dhënë përgjigje për çfarë kërkojmë ne pa të keqen që bëjmë, sillen pa etikë. Dje ka ndodhur një incident, po kërkoja vendimet e zbardhura nuk mi jepnin, më në fund kërkoja të më jepnin numrat dhe një punonjës këtu mi dha dhe u bë shamatë pse unë mora numrat e vendimeve. Ti vendimin e zbardhur nuk ma jep, numrin nuk ma jep, unë si do të ankohem më thuaj ti, prandaj unë i shoh këta punonjës të papërgjegjshëm. Kam dhe një kërkesë tjetër, te kjo kërkesë në qoftë se është e mundur të shtoj dhe numrin 139. Pra unë kërkoj që ta shtymë këtë seancë të marrim vendimet e zbardhura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ta plotësojmë kërkesën ashtu siç duhet edhe ta paraqesim këtu dhe ne jemi të sigurt që deri në këtë moment ne kemi zbatuar me kujdes. Me edukatë kemi ardhur këtu në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se jemi dhe deputet dhe të bëjmë kujdes kur vijmë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pavarësisht se kemi pasur mundësi që ta çojmë zërin pak edhe më shumë, por nuki kemi ardhur këtu për t'i dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vlerën e saj siç e ka dhe ta bëjmë që të punojnë ashtu siç duhet se ne e dimë që partia ose koalicioni ynë ka në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve njerëz që janë shumë të interesuar që në Shqipëri mos të ketë zgjedhje të duhura në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe në zgjedhjet në Shqipëri të bëhen në mënyrë antikushtetuese ku shqiptarëve mos t'i jepet e drejta të votojnë gjysma e shqiptarëve që jetojnë jashtë shtetit. Atyre që na mbajnë me bukë shtetin shqiptar që kanë punuar 30 vjet në kazëm, kanë sjellë dhe 3-4 fëmijë edhe i japin një pension dhe 30 mijë e 40 mijë e janë detyruar të ikin jashtë shteti dhe atyre as

4

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

të drejtën kushtetuese nuk e japin, ama atje kur vjen emigranti ia kërkon taksën atë taksën e shtëpisë që ka këtu e me rradhë.

Z. K. Bele: Zoti Jenishehri të kthehemi te formaliteti i seancës.

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Nuk ka vullnet në Komision Qendror të Zgjedhjeve që të shqyrtohet sipas ligjit, sipas kodit e kështu me rradhë. Prandaj unë kërkoj të pajisemi me vendimet e zbardhura, të plotësojmë kërkesën duke qenë në kushte normale për ta plotësuar kërkesën mandej Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administrata le të paraqesë pretendimet e veta, faleminderit.

Z. K. Bele: Faleminderit zoti Ylli kishit gjë për të sqaruar?


Z. Y. Merkaj: Atëherë vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve janë marrë në datën 23.06.2021, me urdhër të Komisionerit 12 vendimet për 12 qarqe janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë qenë të arsyetura që atë ditë.

Z. K. Bele: Pra vendimet sot aktualisht janë publike dhe në faqen zyrtare.

Z. Y. Merkaj: Që në datën 23 sapo ka mbaruar mbledhja, pas një ore janë publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të arsyetura të 12 vendimet për 12 qarqe. Kështu që preetendimi nuk qëndron.

Z. K. Bele: Faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*


Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Asnjëherë kam ardhur përditë këtu për t'i marrë vendimet e zbardhura se për çfarë të ankohemi kur nuk i kemi vendimet? Gjithmonë më kanë thënë nuk është zbardhur, zonja e protokollit çfarë kam për të dhënë kur nuk është zbardhur akoma, sa të zbardhen do t'i jap, nuk i kam akoma, nuk janë zbardhur. Pretendimi ynë për t'u pajisur me vendimet duket qartë se është normale, është një turp i madh një koalicioni mos t'i jepet në dispozicion vendimi me të cilin ai mund të ankohet ose jo.

Z. Y. Merkaj: Më fal zoti relator mesa di unë zotëria ka ardhur për vendimin e KAS-it për vendimin e fundit të KAS-it i cili ka afat 3 ditor. Mesa jam unë në dijeni zotëria, ka kërkuar vendimin e arsyetuar të KAS-it, i cili ka afat 3 ditë jo për këto vendime, këto vendime kanë qenë të arsyetuara që në datën 23.06.2021.

Z. K. Bele: Ky është një diskutim që ne nuk mund të hyjmë në debat dhe në verifikim të thelluar se çfarë ka thënë kush, por nga një verifikim që bëj në faqen e internetit dhe nga sa unë kam parë dhe këto vendime janë të zbardhura ose të paktën nga verifikim paraprak shoh që janë të publikuara zoti Jenishehri.

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: A mund t'i marr në qoftë se janë të zbardhura?

Z. K. Bele: Janë në faqen e internetit dhe janë në akses të publikut mbase KQZ-ja nuk e di prej sa vitesh, vendimet i publikon pastaj nëse merren apo nuk merren në sekretari unë këtë nuk e di dhe nuk mendoj se është e rëndësishme për këtë, por ky është fakt publik i printon nga celulari.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Ne ua kemi shkruar dhe këtu te kërkesa po t'i kishim marrë ato, kjo thotë akoma nuk janë zbardhur.

Z. K. Bele: Dakord ky është pretendimi juaj.

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Më duket krejt absurde pretendimi i Administratës së KQZ-së që mos të shqyrtohet kërkesa jonë, sepse vetë Administrata e KQZ-së nuk na jep vendimin e zbardhur dhe sa të zbardhet na thanë po ua japim.


Z. K. Bele: Të mirëkuptoj zoti Jenishehri e përdorni kompjuterin, e hapni faqen e KQZ-së?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Jo kam folur direkt me sekretaren e zyrës së protokollit po të na kishte thënë ajo që mund ta merrni këtu se atje në filan zyrë kudo që na e kishte dhënë...

Z. K. Bele: Është në internet për të gjithë publikun dakord ju e keni këtë pretendim se kjo mbajt shënim dhe u pasqyrua ky moment lidhur me afatin. Keni ndonjë gjë tjetër për të thënë për formën e vendimit?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Për çfarë?

Z. K. Bele: Për formën keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar veç kësaj kërkesës suaj?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Për kodin?

Z. K. Bele: Përveç se sa thatë keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar për formën e ankimit dhe për çfarë element ka forma?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Vetëm nenin 139 kam kërkesë që ta shtojmë.

Z. K. Bele: Në bazë ligjore “faktet e njohura botërisht dhe ekspertimet” dakord është mbajtur shënim dhe do të shtohet si një nga elementët e kërkuar që në bazën ligjore të jetë dhe neni 139, i cili është pjesë integrale e kërkesës së ABEOK. Keni ndonjë pyetje?

Z. I. Rusmali: Të gjitha vendimet që ju keni cituar dhe që ankoheni ndaj tyre janë vendime për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonat zgjedhore sipas 12 qarqeve për zgjedhjet e datës 25 prill. Ju keni pretendim si subjekt zgjedhor për ndonjë mandat që mund t’iu jetë mohuar juve?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Si thatë?

Z. I. Rusmali: Keni pretendime që juve ju takojnë mandate nga zgjedhjet?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Ne kemi pretendim që ndarja e mandateve që ka bërë KQZ-ja me datën 23 Qershor, është në kundërshtim të hapur



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

me ligjin në Kodin Zgjedhor dhe këtë gjatë seancës nëse do të vendosni që ta bëjmë seancën ne do të provojmë katërcipërisht këtë.

Z. I. Rusmali: Përpara se ne të shkojmë në seancë ne duhet të provojmë që ju keni të drejtë të vini tek ne për shkak se iu është cënuar një interes i ligjshëm. Vendimet kanë lëndë, kanë objekt dhe objekti i tyre është shpërndarja e mandateve. Interesi i ligjshëm do të thotë që ti pretendon të të jepet një mandat dhe ty vendimi sta ka dhënë mandati ky është interesi i ligjshëm. Jemi përpara këtij rasti apo jeni në vlerësimin e përgjithshëm për zgjedhjet në Shqipëri.

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Ne kemi interes të ligjshëm se jemi prekur shumë rëndë nga kjo gjë, sepse ne në koalicionin tonë jemi Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë, Partia e Emigrantëve Konservator edhe Ora e Shqipërisë. Meqënëse një prej subjekteve tona politike që përmbajnë koalicioni është Partia e Emigracionit por jo vetëm edhe partitë tona janë shkelur të drejtat kushtetuese, nenet e Kodit Zgjedhor në të cilat në mënyrë më flagrante nuk janë marrë vendimet që e ka për detyrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për t'i marrë ato vendime nuk i ka marrë. Kur ai nuk i ka marrë kodi është aty kodi thotë në qoftë se ti nuk i merr vendimet pra në qoftë se ti vepron ose nuk vepron për ti dhënë jetë kodit ti e ke shpërdoruar detyrën. Prandaj këta duke e shpërdoruar detyrën, duke mos i dhënë të drejtë dhe të drejtën kushtetuese ama që emigrantëve i është dashur për të marrë vendim duke i thënë ju emigrantë do të vini për të votuar me një këmbë me një dorë, me dorë të djathtë me dorë të majtë mos të vini hiç për ju votojmë ne, me marrë një vendim sepse thotë kodi neni 24 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë një vendim sesi ka për të qenë një vendim e di ai, por pa u marrë vendim emigranti nuk ka si ta dijë ai sesi do të votojë si ka për

9

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021**


ta ditur ai. Ai duhet ta dijë se kodi tjetër është shfuqizuar kodi i ri i thotë atij për ta votuar atje ku është, ti nuk ia tregon atij se si do të votojnë tani, pra jemi në një shkelje të këtij neni. Atëherë pasoja e saj është që elektorati ynë që mos të themi 100% përshembull për Partinë e Emigracionit por edhe për parti të tjera që janë në koalicionin tonë, ata janë prekur interesat e tyre që nuk i kanë lënë për të votuar. Biles një shqyrtim tjetër që kishim në KAS këtu që kemi bërë përpara kisha në krahë të majtë Ilmi Plavën është një mjek në Belgjikë ishte emigrant. Ishte i revoltuar dhe tha dua të vi ta dëgjoj e i thashë të lutem mos fol. Kur doli jashtë tha bëre gabim që nuk më le të flas, i thashë që nuk ke të drejtë të flasësh se atje ka rregulla mbledhja. Ishte shumë i revoltuar e tha që janë rreth 70 mijë emigranta në Belgjikë se është doktor në Bruksel dhe është kryetar i të gjithë Shoqatës së Emigracionit në Belgjikë të Shqiptarëve.

Z. I. Rusmali: Si e kishte emrin?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Ilmi Plava është mjek nuk është normale kjo gjë prandaj interesat e partisë sonë e koalicionit tonë se nuk kemi ardhur këtu për të bërë debate, por në qoftë se do të ishin bërë zgjedhjet ashtu siç duhet të bëheshin si thotë Kodi Zgjedhor. Një argument kisha i nderuar, populli shqiptar gjysma e popullit shqiptar besoj se e pranojnë të gjithë se janë në emigracion. Në Shqipëri jeton gjysma, kjo gjysëm e kësaj gjyse nuk kanë ardhur në votime arsyet nuk po i them, gjysma nuk ka ardhur arsyet janë atje. Pra gjysma e gjysës pra çereku i takon, ky çereku gjysma ka votuar militantët e PD-së për PD-në, gjysa e çerekut e 1/8 i takon për militantët e PS-së. Pavarësisht se militantët e PS-së që janë më burra të mirë e më të zotë për të bërë gjithçka i kanë fituar zgjedhjet po të ishin këto zgjedhje të ishin bërë si thotë kodi në qoftë se do të thoshte kodi për t'u

10

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021**


bërë kështu. Pra me 1/8-ën me vullnetin e 1/8-ën e shqiptarëve këta duan ta sundojnë 7 tjerë. Me këtë shqyrtim që bëjmë këtu ne i themi shqiptarëve që këtu deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, anëtarët e KAS-it janë burra që kanë vullnet që për ta çuar jetën e shqiptarëve përpara dhe përpara iu shkon vetëm atëherë kur ne e vemë drejtësinë drejtësi. Atë që është vendosur në parlament ta zbatojmë ashtu siç është thënë aty dhe pastaj populli e di vetë se çfarë bën se kush ka qejf të udhëheq. Në këtë territim të këtij problemi unë them që kemi mundësi dhe duke aprovuar kërkesën tonë për ta shqyrtuar këtë në seancë ku ne do të provojmë katriciprisht, sepse ajo që ne kemi pretenduar tek ky objekt i kësaj kërkesë qëndron ligjërisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë me Kodin Zgjedhor dhe me rradhë, faleminderit.

Z. K. Bele: Një pyetje pa paragjykuar themelin e çështjes sepse është një fazë tjetër, pra ju mendoni se ndërmjet kësaj kërkesë të realizohet pavlefshmëria e zgjedhjeve dhe të bëhen zgjedhjet në një kohë tjetër pasi të garantohet e drejta e emigrantëve për të votuar nga jashtë. Pra të vazhdojë parlamenti dhe për një kohë të pacaktuar?

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Jo të pacaktuar ne pretendojmë t'i japim jetë Kodit Zgjedhor kështu siç thotë kodi në qoftë se kodi thotë mos bë zgjedhje asnjëherë më, ne themi çfarë thotë kodi ne do të provojmë. Kërkojmë që të bëhet kjo seancë do të provojmë, sepse pretendimi ynë është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kodin Zgjedhor. Ne nuk mund të pranojmë në asnjë mënyrë që gjysma e shqiptarëve mos të kenë të drejtë për të votuar përderisa ia ka dhënë të drejtën ligji se jemi shqiptar dhe kemi nderin e shqiptarit.

11

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

Z. I. Rusmali: Një pyetje për administratën, ju thatë që kërkesa është paraqitur jashtë afatit apo jo? Mund të na arsyetoni, si e arsyetoni afatin juve data 23 është data e vendimit, data 28 është data e depozitimit.

Z. Y. Merkaç: Atëherë referuar nenit 9 të rregullores së KAS-it, pika 8 ku citohet se kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrjnë interes të ligjshëm për çështjet objekte ankimi. Në periudhën nga ndarja e dekretit të Presidentit për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar ankimi paraqitet brenda tre ditëve nga marrja e vendimit, do të thotë që marrja e vendimit është me datën 23 duke nisur nga nisja e shpalljes por nga dita që është marrë vendimi, duke llogaritur 23, 24 llogaritet data 25 është afati i fundit i paraqitjes së ankimit.

Z. S. Jenishehri, përfaqësues i ABEOK: Dje paradreke që kam ardhur përditë këtu meqënëse kam takuar zotin Olsi, kam folur me të personalisht. Të them të drejtën e falenderoj për atë marrëdhënie që ka të paktën me koalicionin tonë dhe i sqarova këtë problem që nuk janë zbardhur akoma dhe i thashë se po mbaron afati bashkë numëruam dhe tha sot mbaron afati. Ajo zonja që i dorëzova dje pyeti dikë në administratë dhe pas pak minutash erdhi dhe zoti Olsi aty dhe e pranuan këtë se po të ishte ashtu që do ta kishin thënë nëse nuk do të ishim brenda afatit atëherë Administrata e KQZ-së nuk do ta merrte, e mori na dha dhe numrin e protokollit dhe unë fola me drejtorin juridik dje e kam takuar. Po të na thoshin u ka mbaruar afati nuk keni të drejtë të merrni vendimet ju mbaroi ne vijmë e marrim vendimet këtu. Ne mund të caktojmë dhe dikë tjetër t'i marrë përderisa ne vijmë këtu, vijmë te organi që është për këtë punë. Nëse kemi bërë ndonjë shkelje nëse do të

12

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 29.06.2021*

shqyrtohet në qoftë se nuk kemi të drejtë, KAS-i nuk do të marrë vendim pse po i themi ne nuk i kemi bërë lutje ndonjë herë KAS-it që të na dalë zot, por ne kemi vullnet të jashtëzakonshëm që KAS-i të zbatojë ligjin dhe ne jemi deputet atje që kemi zemër shpirt për popullin tonë.

Z. K. Bele: Mirë zoti Jenishehri ju falenderojmë ne do ta vlerësojmë në raport me ligjin lidhur dhe këtë moment. Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër në këtë fazë KAS tërhiqet për vendim për të vlerësuar nëse jemi para asaj çfarë parashtroam pra për kalimin ose jo në shqyrtim të ankimit. Do të marrim një kohë të arsyeshme 15 minuta në parim ne do të mblidhemi në orën 13:20 për ta shpallur vendimin.

Rifillon Mbledhja

Ora: 13:20

Z. K. Bele: Atëherë KAS në përfundim të shqyrtimit mbështetur në nenet 21, 126, 130 germa "c", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në nenet 17 pika 3 shkronja "b" dhe neni 18 pika 1 shkronja "c", vendimit nr.03 të Komisionit Rregullator vendosi:

Mospranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr.56, datë 28.06.2021, të paraqitur nga Koalicioni ABEOK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një afati 5 ditor nga shpallja e tij në Kolegjin Zgjedhor.

Kjo seancë deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr.97

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*

